



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 10/2011
Prishtinë, më 17.05.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostić.

Pjesëmarrës të tjerë: Sabit Gashi dhe Alban Çollaku – MZHE; Ukë Gashi - ZPRK; Haxhi Gashi- USAID; Besnik Ramadanaj – KDI dhe Sanije Berisha- OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina. dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.05.2011;
3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit për Eficiencën e Energjisë Nr. 04/L-016;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.05.2011;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10.05.2011, u miratua me vërejtjet e deputetit Lutfi Zharku.

3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit për Eficiencën e Energjisë Nr. 04/L-016

Kryetari – fillimisht i njoftoi anëtarët e Komisionit se ka pasur një takim me Kryetarin e Kuvendit dhe Kryetaret e komisioneve parlamentare për t'i përshpejtuar disa projektligje që janë në shqyrtim në Kuvend, ku janë disa afate të dhëna nga Komisioni Evropian, dhe ne si Komision funksional i kemi 4 Projektligje,. Po ashtu janë cekur edhe në Raportin e Progresit për Kosovën, tani janë në procedurë dhe kërkoj nga grupet punuese që ta përshpejtojnë amendamentimin për miratim. Në vazhdim, kryetari i Komisionit njoftoi se për këtë pikë të rendit të ditës, që do të shqyrtohet në parim Projektligji për eficiencën e energjisë, në mbledhje të pranishëm janë përfaqësuesit e ministrisë përkatëse Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, dhe çdo paqartësi mund të na sqarojnë.

Myzejene Selmani – tha që edhe në legjislaturën e kaluar ky ligj pat ngelur pa u përfunduar, mirëpo nga legjislacioni i kaluar e deri më tani po thuajse është ligj identik asgjë nuk ka ndryshuar. Dhe mendoj se në bazë të amendamentimit nga ana e anëtarëve të Komisionit të del një ligj i mirë sepse është një ligj me rëndësi. Mendoj se ky ligj bënë pjesë në paket e ligjeve të energjisë, shpresoj se të gjithë deputetët edhe stafi mbështetës i cili e mbështet komisionin parlamentar do ta japin kontributin që në fund të nxirret një ligj shumë i mirë. Sepse është një ligj shumë me rëndësi për Kosovën, besoj që deputetët ta japin maksimumin në kuadër të Komisionit por edhe mbështetësit të tjerë të cilët e mbështetësin Komisionin tonë parlamentar që në fund ta kemi një ligj çfarë i nevojitet këtij vendi.

Sabit Gashi (Ministria e Zhvillimit Ekonomik– MZHE) - theksoi se është e vërtetë që nuk ka pasur ndryshime të mëdha, për vetëm në disa direktiva, sepse këto direktiva janë shfuqizuar nga Komisioni Evropian dhe ne i kemi përshtatë me një vendim të Komunitet ndërkombëtar të energjisë, sepse ne jemi anëtarë në këtë Komunitet. Kjo është bërë lidhur me detyrimet që kanë palët kontraktuese me Komunitetin e energjisë për t'i zbatuar këto detyrime të transpozimit, në këtë drejtim ne kemi inkorporuar direktivat e reja dhe i kemi futur në projektligj. Përndryshe ky ligj është kornizë dhe themelon Agjencinë dhe thelbi është neni 13 ku kërkon transpozimin e direktivave evropiane të Bashkimit Evropian.

Sala Berisha-Shala - theksoi që ky projektligj ka qenë edhe në mandatin e kaluar, por për shkak të përfundimit të mandatit të legjislaturës para kohe ka mbetur pa u përfunduar. Në atë kohë kur e kemi pas në shqyrtim, në plan të punës kemi pas një dëgjim publik. Ne si Komision ta përshpejtojmë dhe kërkoj nga deputet që ta mbështesim, sepse projektligji është i mirë dhe duhet t'i përshtatemi rrethanave për ndryshime. Propozoi që të organizohet një dëgjim publik për këtë projektligj gjatë fazës së amendamentimit.

Berat Buzhala - pyeti së cila është strategjia pas aprovimit të këtij projektligji dhe çka keni me ndërmarr ju si ministri për zbatimin e këtij ligji?

Sabit Gashi (Ministria e Zhvillimit Ekonomik– MZHE) - theksoi se duhet me u themeluar Agjencia për Eficiencën e Energjisë që është kërkesë e Komunitetit të energjisë dhe Këshilli Certifikues i auditimit të energjisë që është po ashtu kërkesë e Komunitetit të energjisë, dhe me u transpozu këto direktiva para datës 31 dhjetor 2011.

Berat Buzhala - pyeti çka ka më ndodhe në terren kur të bëhet implementimi i këtyre agjencive si kemi më qenë më efikas me Eficiencën e Energjisë?

Sabit Gashi (Ministria e Zhvillimit Ekonomik– MZHE) – tha se kemi me qenë më efikas në menaxhimin e kërkesës për energji, detyrimet e sektorit publik sidomos zyrtat e prokurimeve publike që kanë për detyrë me pais me paisjet siç janë llampat ndriçuese dhe shumë elemente, për me qenë më efikas që nënkupton mos shpenzimin e energjisë së përgjithshme deri në 20%. Kjo është marrëveshje e gjitha shteteve të Komunitetit të energjisë palë e së cilës është shteti i Kosovës. Ne jemi në bashkëpunim edhe me Sekretariatit e energjisë për këtë çështje, dhe kemi marrë detyrim që ta monitorojmë vënien e pajisjeve eficiente dhe Komisioni Evropian është duke na parakrah në këtë fushë edhe me mjete financiare.

Myzejene Selmani - theksoi se në bazë të marrëveshjes së Athinës ne jemi të obliguar ta kemi ligjin e eficiencës së energjisë mirëpo sa do të arrijmë që ta kemi në zbatim mendoj se është nonsens. Ndërsa sa do të jemi ne eficient t'i plotësojmë tri konditat 20 plus 20 ne duhet ta themi realitetin jemi të obliguar të mundohemi që ta arrijmë së paku 5% të eficiencës së energjisë për ne do të jetë shumë mirë.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-016 për Eficiencën e Energjisë.

Dhe Kuvendit i parashtron këtë

Rekomandim

- 1. Të miratohet në parim, Projektligji Nr. 04/L-016 për Eficiencën e Energjisë.*
- 2. Arsytimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.*

Kryetari – propozoi që të formohet një grup punues prej tre (3) anëtareve të Komisionit për amendamentimin e Projektligjit Nr. 04/L-016 për Eficiencën e Energjisë Nr. 04/L-016.

Pas diskutimeve Komisioni unanimisht nxori këtë

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi punues për të shqyrtuar Projektligjin Nr. 04/L-016 për Eficiencën e Energjisë.*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Berat Buzhala raportues, Fikrim Damka dhe Lutfi Zharku.*
- 3. Grupi punues në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e Veprimit, dhe brenda afatit prej dy muajve të paraqet propozim-amendamentet në Raport me shkrim Komisionit për shqyrtim dhe miratim.*

4. Të ndryshme

a) Tryeza “Përmirësimi i kornizës ligjore për mjedisin biznesor në Kosovë”

Kryetari – i njoftoi deputetët së më 18.05.2011 do të organizohet një Tryezë nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në bashkëpunim me NDI -Instituti Kombëtar Demokratik. Kjo Tryezë do të quhet: “Përmirësimi i kornizës ligjore për mjedisin biznesor në Kosovë”.

b) Aktivitet e radhës te Komisionit;

Kryetari – i njoftoi deputetët se është caktuar takimi për një vizitë pune në Ministrinë Tregtisë dhe Industrisë me datën 23.05.2011.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit**